



Raporti Vjetor 2017

Përmbajtja

- 2 Kush jemi ne
- 3 25 Vite Caritas Kosova
- 6 Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor
- 7 Lufta Kundër Trakifimit me Njerëz
- 9 Paqa dhe Diversiteti
- 11 Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara
- 12 Përfshirja Sociale e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
- 16 Ushqim për të gjithë
- 18 Përtej Portave të Burgut
- 20 Edukimi i Fëmijëve
- 21 Ekonomia Sociale
- 23 Emergjencat
- 24 Buxheti Vjetor

Kush jemi ne!

Cartias Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis (CI) dhe Caritas Europa (CE) që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim race, kombësie, religjioni, etj. Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2017, në përputhje me strategjinë, ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të 4 mandateve operationale: Asistenca Sociale dhe Shëndetësore, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Avokimi dhe Lobimi, dhe Asistenca në Emergjencë dhe Rehabilitimi i Qëndrueshëm (në gatishmëri). Nëpërmjet veprimeve të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

Udhëheqja jonë

President i Caritas Kosova është Mons. Dodë Gjergji - Ipeshkëv i Kosovës dhe Drejtor Gjeneral është Don Viktor Sopi.

Duke u ballafaquar me shumë çështje në Republikën e Kosovës, ku ndër problemet më të mëdha mbetet papunësia si dhe varfëria ekstreme që janë rrënja e shumë problemeve në shoqëri "Si Caritas Kombëtar, ne përpiqemi që të jemi dora e dashurisë dhe kujdesit, sidomos në komponentën sociale, për të gjithë njerëzit që kanë vajin në buzë, që vuajn nga sëmundja, izolimi, vetmia, përjashtimi, në mënyrë që secili të ndiej ngrohtësi, të buzëqesh, të jetë i përfshirë në shoqëri dhe të jetoj me dinjitet" - Don Viktor Sopi.

Të nderuar partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë në vitin 2017.

25 vite Caritas Kosova

Caritas Kosova më 8 dhjetor 2017 në mënyrë solemne ka shënuar 25 vjetorin e themelimit me një ngjarje të madhe ku prezent ishin mbi 1000 perosna që e bënë edhe më madhështore këtë festë. Misioni dhe puna e Caritasit ndër vite u vlerësua shumë lart nga përfaqësues të ndryshëm nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, partner ndërkombëtar – përkrahës të Caritasit si dhe përfitues të ndryshëm. Në hapje u lexua dekreti origjinal i themelimit të Caritasit të Kosovës i datës 21 Shtator 1992. Unë pata kënaqësinë që si Drejtor Gjeneral i Caritas Kosova të flas në përgjithësi për historikun si dhe rrugëtimin e Caritas Kosova, theksova se Caritasi ndihmoi familjet nevojtare në çdo cep të Kosovës. "Njeriu ka nevojë për gjithçka, më së shumti për dashuri,

mirësi dhe prandaj motoja jonë është dashuri, solidaritetet dhe paqe, nëse këto komponente ndahen me atë që e ke afër, dashuria rritet dhe bëhet më e madhe, prandaj ju ftoj që në të gjitha angazhimet tuaja si punonjës të Caritasit të bartni ngrohtësinë njerëzore, dëgjoni të sëmuret çka flasin, prekni dhembjet e tyre, përqafoni nevojtarët".

Në fjalën e tij lëshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, kërkoi nga organizatat bamirëse që t'i ndihmojnë njerëzit në nevojë. "Nuk ka fe që e ndalë dashurinë, edhe Caritasi edhe organizatat tjera mos të bëjnë konkurrencë, por të bëjnë garë se kush do të dojë më shumë, kush do të ndihmoj më shumë, e kush do të ketë kujdes më të mirë për njerëzit që kanë nevojë për ne".



Në këtë ngjarje mirënjohjen e madhe për kontributin e Caritas Kosova e shprehu edhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, i cili tha: “Gjej rastin që në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës t’i falënderoj veprimtarët e Caritas Kosova të këtyre 25 viteve për ndihmën e madhe që i kanë dhënë popullit të Kosovës. Ne do t’u jemi përgjithmonë mirënjohës atyre. Ata janë në zemrat e sa e sa familjeve kosovare që gjetën ngrohtësi njerëzore dhe solidaritetin kristian tek Caritasi”. Përfaqësuesi i Caritas Europa z. Marc Sommers theksoi se Caritas Kosova gjatë këtyre 25 viteve ka treguar suksese të mëdha, andaj bëri apel që kjo organizatë të vazhdoj edhe më tutje

misionin e vet. “Caritas Evropa është rrjet i organizatave që përbëhet nga 49 anëtare, por të gjitha këto janë pjesë e konfederatës së Caritas Internationalis që ka mbi 160 organizata anëtare dhe të gjitha këto kanë të njëjtin mision, të luftojnë varfërinë, të promovojnë drejtësinë sociale dhe sistemet e qëndrueshme shoqërore në Evropë dhe në të gjithë botën”, tha ai. Përfaqësues të Qeverisë dhe të nivelit lokal, përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë si dhe përfitues të ndryshëm, folën për punën e Caritas Kosova dhe kontributin që jep në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike në vend.





Në këtë akademi solemne të 25 vjetorit të themelimit të Caritas Kosova, përveç shfaqjes së dokumentarit ku u tregua rrugëtimi dhe kontributi i Caritasit, patëm mundësi të falenderojmë dhe festojmë me të gjithë akterët që kanë lënë gjurmë në këto 25 vite, me punën, angazhimin dhe dashurinë që kanë kultivuar dhe dhuruar për njëri tjetrin dhe për njeriun në nevojë.

Urojmë që të festojmë edhe shumë përvjetore dhe suksese të tjera, sepse si Caritas Kombëtar, ne përpiqemi që të

jemi dora e dashurisë dhe kujdesit, sidomos në komponentën sociale, për të gjithë njerëzit që kanë vajin në buzë, që vuajn nga sëmundja, izolimi, vetmia, përjashtimi, në mënyrë që secili të ndiej ngrohtësi, të buzëqesh, të jetë i përfshirë në shoqëri dhe të jetoj me dinjitet!

Zoti ju bekoftë!

Don Viktor Sopi – Drejtor Gjeneral

Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulator

Përkujdesi Shtëpiak/Home Care - Duke përdorur modelin e Përkujdesit Shtëpiak Gjerman dhe me mbështetjen e Caritasit Gjerman, Ministrinë dhe Komunat, Caritas Kosova ka zbatuar programin e Përkujdesit Social dhe Shëndetësor në shtëpi.

Ky program është zbatuar në 12 komuna ku përfitues janë personat më të cenueshëm dhe të vetmuar, të moshuar dhe të braktisur, personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët mendorë, pavarësisht nga besimi, etnia dhe gjinia e tyre. Mbi 2670 përfitues kanë përfituar përmes këtij programi duke pranuar shumë shërbime bazë. Caritas Kosova mbetet e vetmja organizatë që ofron një shërbim të tillë në Kosovë.

Përkujdesi Ambulator - Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunat, gjatë kësaj periudhe Caritas Kosova ka zbatuar Përkujdesin Ambulator në 12 Komuna. Përmes këtij projekti Caritas Kosova në bashkëpunim me partnerët institucional ka arritur të ofroj mbi 1.2 milion shërbime sociale dhe shëndetësore. Këto shërbime janë ofruar nga 104 mjekë, 400 infermier, 28 stomatologë dhe mbi 80 punëtor social që ua mundësojnë shërbimin mjekësor qytetarëve jo më larg se 4 km nga ku jetojnë. Të dy komponentët e plotësojnë njëra tjetrën duke ofruar një shërbim unik në Republikën e Kosovës.



Partnerët: Caritas Germany, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komunat: Ferizaj, Rahovec, Viti, Gjilan, Mitrovicë, Drenas, Shtime, Istog, Fushë Kosovë, Podujevë, Prizren, Hani i Elezit

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz

Lufta kundër Trafikimit me Njerëz, vazhdon të jetë një nga prioritetet e veprimtarisë së Caritas Kosova. Ky fenomen është plagë serioze që ka ndikuar në njerëzimin në të gjitha kohërat dhe Caritas Kosova është e përkushtuar në parandalimin e kësaj dukurie, me fokus të veçantë tek fëmijët dhe gratë.

Brenda programit të cilin e zbaton Caritas Kosova janë tri komponente: Parandalimi, Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve dhe Mbrojtja dhe Ri integrimi

i Viktimave (potenciale) të trafikimit. Në vijim janë të arriturat për vitin 2017: **Parandalimi** – Caritas Kosova ka kontribuar në parandalimin e trafikimit përmes trajnimit për mësimdhënës dhe këshillin e prindërve për identifikimin hershëm të faktorëve të rrezikut si dhe referimin e rasteve. Këto trajnime janë mbajtur në katër komuna: Gjilan, Klinë, Kamenicë, dhe Hani i Elezit ku gjithsej janë trajnuar 77 mësimdhënës dhe staf shkollor i shkollave fillore.



Ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve – Caritas Kosova në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar ka zhvilluar fushatë vetëdijesimit në muajin kundër trafikimit me njerëz duke filluar nga 18 Tetor 2017 (dita a BE Kundër Trafikimit me Njerëz). Në kuadër të programit është organizuar edhe konferenca vjetore për ngritje të vetëdijesimit. Kjo konferencë është mbajtur në një shkollë fillore në Ferizaj me 30 Tetor ku të pranishëm kanë qenë mbi 200 pjesëmarrës (mësues, nxënës, dhe prindër).

Mbrojtja dhe Ri integrimi i Viktimave (potenciale) të trafikimit –

Në bashkëpunim me Strehimoret në Gjilan dhe Pejë dhe me Qendrat për

punë Sociale, kemi ofruar mbështetje dhe kemi kontribuar në procesin e ri-integrimit për 8 Viktima (potenciale) të trafikimit duke iu ofruar trajnime profesionale.

Si pjesë e Autoriteti Kombëtar, Caritas Kosova ka kontribuar në hartimin dhe rishikimin e planit të veprimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të përmbushur Strategjinë Nacionale (2015-2019) Kundër Trafikimit me Njerëz.

Caritas Kosova po ashtu ka avokuar në platforma regjionale (Euro-Mesdhetar) dhe globale (COATNET) si përfaqësues i shoqërisë civile nga Republika e Kosovës.

Paqa dhe Diversiteti

Programi i Paqes dhe Diversitetit në vitin 2017 paraqet një vazhdimësi të programit “Paqa dhe Pajtimi” i cili zbatohet nga viti 2000. Ky program ngërthen në vete përvojat dhe mësimet e viteve të mëhershme dhe tenton t’i përgjigjet kontekstit soci-ekonomik të shoqërisë në Mitrovicë, pa përjashtime etnike, gjinore, religjioze apo të tjera. Programim aktual ka dy sektorë kryesore, atë Ekonomik dhe Social/Edukativ.

Sektori Ekonomik - gjatë vitit 2017 ka përkrahur aktivitete të ndryshme bujqësore si dhe ka stimuluar ngritjen e kapaciteteve tek individët dhe bizneset me synim aftësimin personal si dhe gjenerimin e përfitimeve me fokus të veçantë tek gratë dhe të rinjtë ambicioz. Konkretisht, me qëllim të ofrimit të mundësisë së shkëmbimit dhe fuqizimit të partneritetit, si dhe të gjetjes së mundësive të reja të marketingut, u organizua pjesëmarrja në Panairin e Bletarisë në Beograd “Tashmajdan 2017” me pjesëmarrjen e 33 bletarëve me përkatësi të ndryshme etnike. Ndërsa vizita dy ditore B2B (Biznesi ndaj Biznesit) me qëllim mbështetjen e lidhjeve me tregun si dhe partneritetin e

gjerë, u organizua tek bizneset në Kosovë dhe Shqipëri me përfshirjen e 11 grave ndërmarrëse të regjionit të Mitrovicës, me përkatësi të ndryshme etnike. Me synim ngritjen e kapaciteteve të fermerëve dhe bizneseve të reja të regjionit të Mitrovicës mbi menaxhimin e biznesit dhe marketingut, u mbajtën trajnime të përshtatura për gjithsej 40 pjesëmarrës nga sektori i bujqësisë dhe biznesit.

Sektori Social / Edukativ - Me përkrahjen edhe nga UNICEF, janë realizuar trajnime të përshtatura me qëllim ngritjen e kapaciteteve tek 50 profesionistët pjesëmarrës që punë të përditshme e kanë mbrojtjen e fëmijëve, si Qendrat për Mirëqenie Sociale, Institucionet Shëndetësore, Sistemin e Referimit të Drejtësisë për të mitur, Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve, etj. Me anë të trajnimit, presim që mekanizmat për identifikimin, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve të përforcohen dhe krijohen mundësi për zhvillimin e shërbimeve të inovacionit dhe zgjidhjeve për të realizuar të drejtat e të gjithë fëmijëve në fjalë

Gjithashtu, me qëllim të parandalimit të dhunës në shkollat fillore dhe të mesme, janë organizuar punëtori dhe aktivitete në teren me prindërit dhe fëmijët. Gjithsej në 16 punëtori në shkollat e rajonit dhe në Qendrat e Hershme të fëmijërisë në Mitrovicën Veriore morën pjesë 200 studentë dhe 50 prindër. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte

identifikimi i dhunës dhe mënyra se si fëmijët mund të mbrohen nëse janë në pozitë të viktimave. Po ashtu me qëllim të kultivimit dhe promovimit të vullnetarizmit Caritas Kosova ka angazhuar 29 vullnetarë në aktivitete dhe ngjarje të ndryshme në kuadër të këtij programi.



Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara

Kujdesi dhe edukimi i hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara (0-6 vjeç)

– Caritas Kosova vazhdon të ofrojë shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara me fokus në edukimin e hershëm të fëmijëve. Krahasuar me vitet e kaluara, CK në vitin 2017 ka nisur një komponentë tjetër në këtë projekt. Arsimi gjithëpërfshirës si komponent e re ka treguar rezultate shumë të larta në fund të vitit 2017.

CK ka angazhuar 5 asistentë të fëmijëve (psikologë) të cilët mbështesin përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt shkollor si dhe ofrojnë shërbime arsimore dhe sociale për këta fëmijë duke përdorur dhomat burimore të krijuara brenda shkollave.

Qendra e kujdesit të hershëm dhe edukimit numëron 48 fëmijë me aftësi të kufizuara të ndryshme si dhe prindërit e tyre si përfitues direkt. Përveç aktiviteteve të përditshme në mësim, sociale dhe fizike të ofruara në qendër, një veprim i rëndësishëm është regjistrimi i fëmijëve në sistemin e rregullt shkollor si pjesë e strategjisë së re të përfshirjes. Si rezultat i angazhimit tonë në vitin 2017 ne kemi arritur të regjistrojmë tetë fëmijë me aftësi të kufizuara në programin e rregullt parashkollor dhe shkollor.

SOCIETIES/Mbështetja e OSHC-ve në Fuqizimin e Aftësive Teknike, Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Standardet e BE-së në Evropën Juglindore - Caritas Kosova është anëtare e 15 organizatave të tjera nga Evropa Lindore dhe Italia që është bashkuar në zbatimin e projektit SOCIETES.

Gjatë vitit 2017, Caritas Kosova ka vazhduar me trajnimin për OSHC-të që merren me personat me aftësi të kufizuara dhe shëndetin mendor në Kosovë. Trajnimet në: Lobim dhe Avokim, Ndërtimi i Rrjetit dhe Ndërtimi i Koalicionit dhe Menaxhimi i Inicativave të Përfshirjes Sociale ishin tema të elaboruara nga ekspertë nga Bullgaria dhe Italia. Vizita e parë studimore në Bullgari u organizua në vitin 2017, e cila synonte të shihte praktikrat më të mira të përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe çrregullime të shëndetit mendor. Pjesëmarrësit nga Kosova patën mundësi të vizitojnë shoqata të ndryshme dhe shërbimin e OShC-ve që ofrojnë në vendet e BE-së.

Gjatë vitit 2017, Caritas Kosova lansoi thirrjen për grante për OSHC-të që ofrojnë shërbime për PAK dhe çrregullimin e shëndetit mendor në Kosovë dhe i inkurajoi ata që të aplikojnë. Janë dërguar 21 aplikacione për projekte dhe ekipi i vlerësimit të jashtëm pas rezultateve të vlerësimit ka shpallur 4 OSHC si fitues të granteve të cilat më

pas janë kontraktuar nga Caritas Kosova dhe më tutje kanë filluar të zbatojnë projektin e tyre.

Një tjetër komponentë e rëndësishme e këtij projekti është formimi i grupit të Përfshirjes Sociale, i cili rregullisht trajton dhe përpunon nevojat dhe sfidat me të cilat përballen OShC-të dhe njerëzit me aftësi të kufizuara.

Partnerët: Bashkimi Evropian, Caritas Austria

Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Caritas Kosova punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të mëdha,

sidomos me papunësinë, mos përfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj.

Qendra Sociale-Edukative 'Caritas Kosova' në Dubravë, Ferizaj - ofron edukim për 240 nxënës të klasave 1 deri 9, si dhe edukim parashkollorë për 60 fëmijë të moshave 3.5 deri në 6 vjeç si dhe programe të veçanta për zhdukjen e analfabetizmit. Gjithashtu, një nga caqet tjera drejt arritjes së gjithë përfshirjes në jetën sociale të komuniteteve në fjalë, në fshatin Dubravë, janë edhe shërbimet shëndetësore të shëndetit primarë dhe dentarë.



Në kudër të komponentës së edukimit dhe ndërgjegjësimit socio-kulturor janë organizuar aktivitete për shënimin e ditëve dhe festave ndërkombëtare si: 1 Qershori- dita ndërkombëtare e fëmijëve me mysafirët nga Spanja të cilët preformuan muzikë flamengo-gitarë dhe vallëzim "QaQa". Pjesë e programit artistik ka qenë dhe preformimi i shfaqjes "Ne jemi bota" e mbështetur nga "Qendra Multimediale" dhe stafi profesionist i saj me aktorë dhe regjisorë e cila është pritur jashtëzakonisht mirë nga audienca e përbërë nga banorët e fshatit. Gjithashtu është mani-

festuar "Dita ndërkombëtare e tolerancës" më 16 Nëntor me një program dhe koktej. Gjatë vitit 2017 aktiviteteve rutinore të qendrës u janë bashkuar dhe grupi i vullnetarëve nga Caritasi Italian të cilët fasilituan dhe animuan aktivitete mjaft atraktive të tipit psiko-social me përmbajtje mbi temat ekologjike dhe të ushqyerit të shëndetshëm me fëmijët e moshave 9-11 vjeç. Banorët e fshatit Dubravë janë përkrahur nga Caritas Kosova me pako me veshmbathje dhe pako ushqimore me ç'rast gjatë vitit 2017 kanë përfituar rreth 1300 banorë.

Gjatë vitit 2017 në Ambulantën në kuadër të Qendrës ka pasur një frekuencë të përgjithshme prej 3590 raste mjekësore, nga të cilat 851 shërbime dentare dhe 2739 kontrolla nga mjeku i përgjithshëm. Në kuadër të shërbimeve shëndetësore, gjatë vitit 2017 janë organizuar disa sesione sensibilizuese me tema mbi shëndetin dhe planifikimin familjarë si ato të “Parandalimit të virusit të fruthit” dhe “Informimi mbi pasojat, dhe parandalimi i Tuberkulozit” me panel nga stafi edukativ dhe mjekësorë me pjesëmarrje të mbi 200 participantëve të grupëmoshave të ndryshme nga fshati Dubravë.

Qendra Sociale-Edukative ‘Caritas Kosova’ në lagjen Ali Ibra, Gjakovë - 185 fëmijëve iu janë ofruar shërbime

edukative dhe aktivitete psiko-sociale, në baza ditore. 40 fëmijë të moshave 4 deri në 6 vjeç kanë ndjekur edukimin parashkollor. Ndërsa 145 fëmijë të shkollave fillore kanë vijuar programin e mësimi plotësues.

Në vitit 2017, Ekipi i Home Care ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për 45 persona të sëmurë të lagjes Ali Ibra. Po ashtu janë organizuar 6 trajnime në fushën e shëndetit për mbi 90 gra dhe fëmijë. 80 fëmijë nga 0-18 vjeç janë vaksinuar nga institucione shtetërore në ambientet e Qendrës.

10 fëmijë të kthyer nga Mali i Zi kanë ndjekur orët e gjuhës shqipe si përgatitje për integrim në sistemin publik shkollorë.



Programi Portage në Mahallën e Romëve në Mitrovicë - 85 fëmijë nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë përgatitur për përfshirjen e tyre në procesin arsimor përmes zbatimit të "Portage Program". Në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF, Zyra Regjionale e Caritas Kosova në Mitrovicë, filloi aktivitetet e ndërgjegjësimit ndaj komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Mahallën e Romëve mbi vaksinimin e fëmijëve. Falë këtyre aktivitetëve, qëndrimi i kundërshtueshëm i prindërve lidhur me procesin e vaksinimit ndryshoi. Si rezultat, 270 kërkesa për imunizim të fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali

dhe Egjiptian janë dërguar nga Instituti i Shëndetit Publik tek Caritas Kosova. Mes këtyre, 88 kërkesa nuk janë marrur parasysh derisa 182 fëmijë janë përgjigjur pozitivisht procesit të imunizimit, proces ky i cili do të zbatohet në periudhën vijuese në të dy anët e Mitrovicës. Është tejet e rëndësishme të ceket që për herë të parë që nga fundi i vitit 1999, falë procesit të vaksinimit të fëmijëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, është arritur bashkëpunimi institucional në mes të Qendrave Shëndetësore, asaj në veri dhe në jug të Mitrovicës, përderisa Caritas Kosova kishte rolin e fasilituesit në këtë proces.



Ushqim për të gjithë

Përkrahja e të varfërve vazhdon të jetë një nga preokupimet kryesore të Caritas Kosova. Të ndihmuar nga organizata vullnetare gjermane Junge Leute Helfen, gjatë vitit 2017 kemi shpërndarë mbi 148 ton me ushqim dhe veshmbathje për personat në nevojë. Ndihamat humanitare janë shpërndarë në famullitë e lpushkvisë së Kosovës si dhe në komunat: Gjakovë, Istog, Klinë,

Mitrovicë, Prizren, Shtime, Viti, Ferizaj, Prishtinë, Gjilan, Hani i Elezit, etj. Ndihamat janë shpërndarë përmes zyrave komunale për punë sociale, shoqatave të të moshuarve, etj.



SELO - Gjatë vitit 2017, zyra regionale e Caritas Kosovës në Leposaviq vazhdoi me programin "SELO".

Ky programi ka si qëllim kryesor përfshirjen socio-ekonomike të komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare për të mbështetur pajtimin afatgjatë. Kjo do të krijojë perspektiva për komunitetet në mënyrë që të kontribuojë në stabilizimin e situatës politike në Kosovë. Programet përfshijnë si përfitues përfundimtar, ndërmarrjet bujqësore të vogla dhe të mesme që i përkasin Organizatave të Shoqërisë Civile që merren me sektorin e Bujqësisë, sektorin e Turizmit Rural, Rininë, Gratë, Sportin dhe Trashëgiminë, me mbështetjen e Institucioneve përkatëse.

Ideja është që të përfshihen të gjithë akterët e synuar në aktivitete të përbashkëta, duke prezantuar njëra-tjetrën dhe duke krijuar mundësi të reja biznesi, këmbim të mallrave, duke shoqëruar dhe promovuar paqen, pajtimin dhe bashkëjetesën. Ne vitin e katërt të projektit kemi arritur bashkëpunim më të mirë në fushën e sigurisë, lehtësimin e

kushteve të jetesës dhe promovim më të mirë të rajonit verior të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe të zbatimit, kemi shpërndarë 15 mëshqerra, gjithashtu kemi organizuar 4 seminare informative, 4 B2B (bizneset për bizneset) dhe 4 vizita studimore në rajon. Në total kemi përfshirë 224 përfitues në këto aktivitete.

Programi "Mikro Kredi për Bujqësi – pa interes"- është në vitin e dymbëdhjetë të zbatimit në komunën e Leposaviqit. Qëllimi kryesor i këtij programi është mbështetja dhe krijimi i qëndrueshmërisë për familjet e zonave rurale duke i furnizuar me pajisje dhe blegtori të nevojshme përmes financimit pa interes. Përfituesit përfundimtarë janë fermerët, njerëz me të ardhura mujore më pak se 300 euro por me dëshirë të fortë për përmirësimin e biznesit të tyre. Gjatë vitit 2017, kemi shpërndarë 98 paketa bujqësore.

Përtej Portave të Burgut

Për vite me radhë Caritas Kosova është përfshirë në mënyrë aktive me aktivitete të ndryshme në Qendrat Korrektuese në Lipjan. Fokus i veçantë i është kushtuar aktiviteteve që ndikojnë në vetëpërcaktimin e të burgosurve si dhe mundësitë për ri-integrimin e tyre me qenë se ata mbeten ende kategori tejet e pa trajtuar. Caritasi Kosova ka vazhduar trajnimet e grave të burgosura në floktari dhe rrobaqepësi. Në vitin 2017 kemi trajnuar stafin e Qendrës Korrektuese si dhe Qendrës për Masa Edukative Korrektuese, në Lipjan, në mënyrë që të zhvillohet qasja në punën me të burgosurit. Trajnimi i titulluar "Humanizimi i Burgjeve", sipas analizave të bëra, ka qenë shumë i nevojshëm dhe ka shërbyer si një pikë kthese për drejtorinë, mbikëqyrësit e lartë,

mbikëqyrësit e ndërrimit, zyrtarët korrektues, punëtorët social, zyrtarët ligjorë, trajnerët për Art Terapi dhe Teatër Terapi dhe vullnetarët e Caritas Kosova në punën me të miturit. Përmes Art Terapisë, si një qasje e re për trajtimin e të miturve të dënuar, kemi arritur të relaksojmë të dënuarit dhe zhvillojmë aftësitë e tyre profesionale dhe ndër-personale me qenë se është cilësuar si një aktivitet që nxjerr në pah shumë talent dhe shpërfaq emocione. Po ashtu, Teatër Terapia ka ndikuar në zhvillimin e empatisë nëpërmjet imagjinatës, zbulimin e kreativitetit, zhvillimin e aftësive për tu përballur me sfidat që ofron shoqëria jashtë dhe brenda mureve të mbyllura, ripërtëritja e imazhit vetanak dhe vetëbesimit.



Së bashku me vullnetarët e Caritas Kosova, bashkëmohatar të të dënuarve, kemi zhvilluar aktivitetet sportive në futboll, basketboll, ping pong dhe ushtrime të ndryshme sportive. Kontakti me jashtë cilësohet tejet i rëndësishëm

nga psikologët me qenë se mundësohet krijimi i lidhjeve shoqërore, shkëmbimi i informacioneve dhe krijimi i përceptimit për zhvillimet e jashtme si dhe mbajtja në formë e fizikut për një jetë të shëndetshme.



Edukimi i Fëmijëve

Secili fëmijë është dhuratë, prandaj është detyrë dhe privilegj i yni për të edukuar dhe përmbushur nevojat e tyre...

Kopshti i fëmijëve "Engjujt" - Caritas Kosova menaxhon kopshtin e fëmijëve me qëllimin të ofrimit të shërbimeve edukuese kualitative të kujdesit ditor për fëmijët të cilët kanë nevojë për një standard të lartë të edukimit. Misioni ynë është krijimi i një vendi të sigurt, të përshtatshëm, të ngrohtë, dhe të planifikuar mirë për fëmijët e moshës 06 muaj deri në 6 vjet në përputhje me veçoritë individuale të secilit fëmijë. Përmes lokacionit shumë të përshtatshëm, hapësirave gjelbëruese dhe

objektit të modeluar posaçërisht për botën e këndshme të fëmijëve, ne krijojmë avantazh në realizimin e plan programit përmes aktiviteteve të cilat kërkojnë hapësirë adekuate.

Kopshti ynë ofron shërbim të kujdesit ditorë për mbi 220 fëmijë në një hapësirë prej 1000m² me një infrastrukturë shumë cilësore dhe të përshtatshme për punë të suksesshme dhe rritje e edukim cilësor të fëmijëve. Kopshti është i licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.



Ekonomia Sociale

Caritas Kosova në vazhdimësi promovon ekonominë social si qasje inovative dhe mekanizëm efikas për zvogëlimin e varfërisë si dhe për të përkrahur përfshirjen sociale dhe punësimin. ELBA (Emergency Labour in Balkans) është një iniciativë e projektuar për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore dhe pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja

dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizatat fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitete, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njerëzit në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.





Caritas Kosova gjatë vitit 2017 ka zhvilluar një vizitë studimore në Athinë për të parë praktikat e ndërmarrjeve sociale në vendet tjera dhe për të adaptuar të njëjtat në Kosovë. Me qëllim të përkrahjes financiare të ndërmarrësive sociale Caritas Kosova ka lansuar thirrjen për grante në të cilën kanë aplikuar 42 aplikantë, prej të cilëve më

pas janë përzgjedhur 3 fitues. Po ashtu Caritas Kosova ka bërë në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e ndërmarrjeve sociale për të parë nevojat dhe ofruar përkrahjen profesionale për mbarëvajtjen e punës dhe arritjen e objektivave të ndërmarrjeve sociale.

Emergjencat

SEECEG/Grupi i Emergjencave i Caritas-eve të Evropës Juglindore – Caritas Kosova vazhdon të jetë anëtar aktiv i SEECEG dhe të jetë në linjë me reagimin emergjent në rast të ndonjë situatë emergjente.

Në tetor 2017 u organizua takimi vjetor në Beograd, takim ky i kryesuar nga Caritas Kosova. Ky takim u pasua edhe me një trajnim të ofruar në Mekanizmin


e Reagimit Emergjent të Caritas Europa si një mjet për të mbështetur më mirë organizatat e Caritas-eve evropiane në përgjigje të emergjencave të vogla në Evropë në një mënyrë efektive dhe të koordinuar. Në këtë takim u vendos që anëtari i Caritas Kosova të zgjidhet edhe për një mandat tjetër si kryesues i këtij grupi.

Buxheti Vjetor

2,734,342.38


Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor	1,831,498.54 €
Lufta Kundër Trafikimit me Njerëz	68,604.58 €
Paqa dhe Diversiteti	95,675.00 €
Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara	149,210.96 €
Përfshirja Sociale e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	216,622.37 €
Ushqim për të gjithë	106,160.96 €
Përtej Portave të Burgut	22,495.00 €
Edukimi i Fëmijëve	104,003.50 €
Ekonomia Sociale	17,500.00 €
Tjera	122,571.47 €

Përqindja sipas Projekteve



- Përkujdesi Shtëpiak dhe Ambulantor
- Lufta Kundër Trafikimit me Njerëz
- Paqa dhe Diversiteti
- Mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Përfshirja Sociale e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian
- Ushqim për të gjithë
- Përtej Portave të Burgut
- Edukimi i Fëmijëve
- Ekonomia Sociale
- Tjera

Përçindja sipas Donatorëve



- Rrjeti Caritas
- Komunat
- Ministritë
- Bashkimi Evropian
- Ambasadat
- Tjera

Zyra Qendrore - Ferizaj

rr. Shën Nënë Tereza nr. 3,
70000, **Ferizaj**, Kosovë
tel. +381 (0)290 328 110
fax. +381 (0)290 396 588
e-mail: info@caritaskosova.org

Zyra Regjionale - Prishtinë

Kisha Katolike, rr Karposh nr. 41
Ulpianë
10000 **Prishtinë**, Kosovë

Zyra Regjionale - Mitrovicë

rr. Tirana nr. 101
40000 **Mitrovicë**, Kosovë

Zyra Regjionale - Prizren

rr. Papa Gjon Pali II nr. 1
20000 **Prizren**, Kosovë

Zyra Regjionale - Gjakovë

Caritas Kosova
Qendra e Komuniteteve Ali Ibra,
50000 **Gjakovë**, Kosovë

Zyra Regjionale - Leposaviq

Vojske Jugosllavije 16,
43500 **Leposaviq**, Kosovë